



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2022:097474  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05875245

KPPP.nr.1129/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Kricons” SHPK, me NUI:811405051, me seli në adresën rr. “Kerem Lewton” p.n., Prishtinë kundër debitorit “The North Unicorn L.L.C”, me NUI:810112186, me seli në adresën rr.”Muharrem Fejza” Royal – Prishtinë duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.209/22 të datës 26.04.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 25.06.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

I.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “The North Unicorn L.L.C”, ashtu që Urdhri P.nr.209/22 i datës 26.04.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj MBETET NË FUQI në tërësi.

## A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.209/22 të datës 26.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.S00099 e datës 07.02.2022 duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrin, t’ia paguajë kreditorit borxhin 3,003.12 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas tarifës së përmbaruesve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se propozimin për përmbarim e karakterizon parregullsia në përmbajtjen e tij, kemi parasysh faktin se propozimi për përmbarim mbështetet në faturë të panënshkruar dhe të pavulosur, rrjedhimisht fatura e lartëcituar mbi bazën e së cilës është iniciuar kjo procedurë nuk i plotëson kushtet ligjore nga neni 29, paragrafi 3 i LPP-së si dhe nenin 20 (1.1.17) të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat. Tutje debitori parashtron se sipas të dhënave të tij lidhur me pagesat e bëra në drejtim të kreditorit, shuma e kërkuar nga kreditori, nuk përkon me borxhin eventuale që mund të ketë ndaj tij, për arsye se debitori ka kryer pagesa tek kreditori në vazhdimësi. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar Prapësimin e debitorit, të shfuqizoj në tërësi Urdhrin Përmbarimor P.nr.209/22 dhe të obligoj kreditorin që t’i paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimin në vlerë prej 156.00 Euro sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit sepse vërehet qartë se qëllimi i tij është vetëm shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit. Tutje Kreditori ka arsyetuar se fatura është dokument i besueshëm dhe i plotëson kushtet për përmbarim sipas nenit 29 par.1 nënpar.3 të LPP-së, kjo për faktin se nëse analizohet fatura shihet se fatura është pranuar me vulë të debitorit dhe mbrapa faturës është bashkangjitur një dëshmi mbi pranimin e mallit e që është pranuar nga debitori me vulë dhe nënshkrim. Lidhur me deklarin e debitorit se vazhdimisht ka kryer pagesa duke i precizuar edhe faturat, kreditori këto pretendime i kundërshton për arsye se debitori ka kryer pagesa më herët duke u bazuar në formatin e njëjtë të faturës mirëpo sa i përket faturës së dhënë sipas propozimit nuk i është përgjigjur detyrimin të tij sikurse në faturat paraprake. Kreditori ka kërkuar nga Gjykata që të

refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të vërtetoj Urdhrin Përmbartimor P.nr.209/22 dhe të obligoj debitorin t'i paguaj shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi për arsye si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentet e besueshme: faturës nr.S00099 e datës 07.02.2022, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimin të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1129/23, me datë 25.06.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.